



Australian Government
Department of Education,
Skills and Employment

Kurse të shkurtëra online

Paketa për ndihmë në arsimin e lartë e Qeverisë së Australisë përfshin kurse të shkurtëra online për punëtorët që janë prekur nga COVID-19.

Kurse të disponueshme ka për infermieri, mësimdhënie, shëndetësi, teknologjinë informative (IT) dhe shkencë. Kostot e kurseve kanë lirime të mëdha për studentët kurse pagesa mund të bëhet përmes HECS-HELP (skemë e ndihmës) për ata që plotësojnë këtë të drejtë.

Kurset do të zgjasin deri në gjashtë muaj dhe do të ndihmojnë punëtorët të zhvillojnë shkathtësi të reja për t'u përgatitur për ekonominë e re pas COVID-19. Për listën e kurseve dhe çmimet e tyre me lirim vizitoni www.CourseSeeker.edu.au apo për më shumë informacione referohuni faqes së resurseve ([Resources page](#)) të uebfaqes CourseSeeker (kërkues i kurseve).